

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Qershor 2023

Tiranë, më 25 Korrik 2023: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Qershor 2023, janë 1.581.731. Ky tregues rezulton me një rritje 16,3 %, krahasuar me Qershor 2022. Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Qershor 2023, janë 1.490.810, duke shënuar një rritje me 18,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Hyrjet e shtetasve

Në Qershor 2023, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 574.698. Ky numër është rritur me 18,9 %, krahasuar me Qershor 2022.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 1.007.033. Ky numër është rritur me 15,0 %, krahasuar me Qershor 2022.

Gjatë gjashtëmuajorit të 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 3.396.932. Ky numër është rritur me 33,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 (tab.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Qershor 2022- Qershor 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 25/07/2023

Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Qershor 2023 janë 576.383. Krahasuar me Qershor 2022, ky tregues është rritur me 15,5 %.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Qershor 2023, janë 914.427. Krahasuar me Qershor 2022, ky tregues është rritur me 19,7 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë gjashtëmuajorit të parë 2023, është 3.024.102, duke u rritur me 20,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Qershor 2022	Qershor 2023	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Qershor 2022	Janar-Qershor 2023	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje gjithsej	1.359.501	1.581.731	16,3	4.813.227	6.348.966	31,9
Shqiptarë	483.445	574.698	18,9	2.259.480	2.952.034	30,7
Të huaj	876.056	1.007.033	15,0	2.553.747	3.396.932	33,0
Dalje gjithsej	1.262.925	1.490.810	18,0	5.009.066	6.248.733	24,7
Shqiptarë	498.857	576.383	15,5	2.519.534	3.024.102	20,0
Të huaj	764.068	914.427	19,7	2.489.532	3.224.631	29,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Qershor 2023, rajoni me numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri është rajoni i Evropës me 954.389 shtetas, pasuar nga Amerika dhe Azia Lindore dhe Paqësori, përkatësisht me 30.082 dhe 8.971 shtetas (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Qershor 2022	Qershor 2023	Janar - Qershor 2022	Janar - Qershor 2023
Gjithsej	876.056	1.007.033	2.553.747	3.396.932
I. Afrika	661	888	1.601	5.101
II. Amerika	26.680	30.082	66.055	85.415
III. Azia Lindore dhe Paqësori	3.128	8.971	9.243	24.031
IV. Lindja e Mesme	4.166	6.099	8.734	11.102
V. Azia e Jugut	1.254	1.800	3.803	6.278
VI. Evropa	782.598	954.389	2.369.541	3.254.947
- Evropa Qëndrore / Lindore	64.929	93.746	123.329	179.517
- Evropa Veriore	32.151	42.511	93.925	119.411
- Evropa Jugore	617.910	707.134	1.940.795	2.627.148
- Evropa Perëndimore	56.906	82.512	171.208	242.478
- Evropa Lindore / Mesdheut	10.702	28.486	40.284	86.393
VII. Rajone të paspecifikuara	57.569	4.804	94.770	10.058

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Qershor 2023, krahasuar me Qershor 2022, hyrjet e shtetasve të huaj janë rritur:

- për qëllime personale me 14,6 %;
- për qëllime pushime, vizitë tek të afërm, etj. me 12,8 %;
- për biznes dhe qëllime profesionale me 59,0 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Qershor 2022	Qershor 2023	Ndryshimi vjetor (%)	Janar - Qershor 2022	Janar - Qershor 2023	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje shtetas të huaj	876.056	1.007.033	15,0	2.553.747	3.396.932	33,0
I. Personale	868.307	994.713	14,6	2.502.453	3.333.751	33,2
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.	850.410	959.520	12,8	2.409.819	3.166.371	31,4
2. Trajtime shëndetësorë	40	12	-70,0	498	362	-27,3
3. Qëllime fetare	69	27	-60,9	244	183	-25,0
4. Udhëtarë transit	17.788	35.154	97,6	91.892	166.835	81,6
II. Biznes dhe profesionale	7.749	12.320	59,0	51.294	63.181	23,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.;
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor.

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.